

PASQYRIMI I MOTIVEVE ETNOFOLKLORIKE DHE NGJARJEVE HISTORIKE NË PIKTURAT E ARTISTËVE TË PARË SHQIPTARË TË KUMANOVËS

Gureta BAJRAMI-BREZNICA

Universiteti i Tiranës, Fakulteti Histori-Filologji, Gazetari dhe Komunikim

gureta_b@yahoo.com

UDC 75.058:39(497.721:=18)

Original scientific paper

Abstract

The study of ethnographic and folklore elements in the visual arts of the first Albanian painters is an indication of the reality of the way of living, dress ornaments, furniture and many events that have directly impacted on organized life but also very difficult. In this paper will be treated the artistic works that represent the ethnic Albanian elements of that area, from the first Albanian painters of the Kumanovo region. In addition to the culinary skills of the development of the economy, since the middle of the twentieth century there has also been development of art and culture as a whole.

In many families the waiting rooms or as they call “the guest’s stoves”, some called it “konak”, on the walls of the environment where they stood and invited familiar and unrecognizable friends, there were also depictions of paintings that were very significant and carried indications ethnographic. The study is based on data from interviews in the Albanian villages of Kumanovo and the painters Rexhai Iseni and Mexhit Bajrami who lived and created artistic works at that time, from additional scientific writings and original documents and books.

Keywords: *Art, tradition, dress, style of cubism and surrealism.*

Përmbledhje

Studimi i elementeve etnografike e folklorike në artin pamor të piktorëve të parë shqiptarë është një tregues i realitetit të mënyrës së jetesës, zbukurimeve në veshje, orendi, ngjarjeve të shumta që kanë ndikuar drejtë për së drejti në jetesë të organizuar por edhe shumë të vështirë. Në këtë kumtesë do të trajtohen veprat artistike që pasqyrojnë elementet etnografike shqiptare të asaj zone, nga piktorët e parë shqiptarë të rajonit të Kumanovës. Përveç mjeshtërive të kuzhinës së pasur të zhvillimit të ekonomisë, qysh nga mesi i shekullit XX ka pas zhvillim edhe arti e kultura në tërësi.

Në shumë familje dhomat e pritjes apo siç i quajnë *sobat e mysafirëve*, e disa i quanin *konak*, në muret e ambientit ku rrinin dhe ftonin miqtë të njohur e të pa njohur, kishte të varura edhe piktura të cilat ishin shumë domethënëse dhe bartnin në vete tregues etnografik. Studimi bazohet në të dhëna nga intervistat në fshatrat shqiptarë të Kumanovës dhe me piktorët Rexhai Iseni dhe Mexhit Bajrami që e jetuan dhe krijuan vepra artistike në atë kohë, nga shkrimet të tjera shkencore plotësuese dhe dokumente e libra origjinale.

Fjalët kyçe: *Arti, tradita, veshjet, stili i kubizmit dhe surrealizmit.*

Hyrje

Me kulturën shqiptare janë marrë etnologët, antropologët, sociologët, historianët etj., të cilët i kanë studiuar në mënyrë shkencore dukuritë të cilat ndodhin si pasojë e shumë faktorëve, transformimeve, ngjarjeve etj. Duke u bazuar në dorëshkrime, shkrime, materiale nga zbulime arkeologjike, por shpeshherë edhe pikturat artistike kanë ndihmuar në hulumtimet e studimeve etnologjike. Ka shumë piktorë që në veprat e tyre artistike pasqyrojnë motivet folklorike, veshjet tradicionale, ngjarjet të ndryshme etj.

Studimi i elementeve etnografike në artin pamor të piktorëve të parë shqiptarë është një tregues i realitetit të zbukurimeve në veshje, orendi, i mënyrës së jetesës, ngjarjeve të shumta që kanë ndikuar drejtë për së drejti në jetë shumë të organizuar, por edhe shumë të vështirë. Nga ekspedita në fshatrat shqiptarë të Kumanovës, pash se përveç mjeshtërive, kuzhinës së pasur, zhvillimit të ekonomisë, qysh nga mesi i shekullit të kaluar ka pas zhvillim edhe arti e kultura në tërësi.

Në familje të ndryshme, në dhomat e pritjes apo siç i quajnë *sobat e mysafirëve*, ku edhe më pritën me shumë dashamirësi, në muret e ambientit ku rrinin dhe ftonin miqtë të njohur e të panjohur, kishte të varur edhe piktura të cilat ishin shumë domethënëse dhe bartnin në vete tregues etnografik. Deri nga mesi i shekullit XX në dhomat e familjeve shqiptare ishin vetëm fotografi të Mekës, ndonjë kalendar fetar, flamuri kombëtar, e asnjëherë nuk ka pasur vepra artistike.

Edhe pse të pakta ishin familjet që kishin vepra artistike, piktura, vizatime ose portrete, me hapjen e shkollave shqipe dhe kuadrove të parë, dolën edhe dy mësues arti të cilët jo vetëm edukonin brezat e rinjë, por arti për ata u kthye në pasion. Në veprat e tyre artistike kanë pasqyruar shumë motive nga folklori dhe nga jeta e përditshme, ngjarjet që kanë ndodhë në atë zonë etj.

Dy artistë shqiptarë Rexhai Iseni nga fshati Mateç dhe Mexhit Bajrami nga fshati Llojan vunë themelin e artit shqiptar modern, duke pasqyruar në pikturat e tyre mënyrën e jetesës dhe ngjarjet historike të shqiptarëve në zonën e Kumanovës. Në stilin modern kanë paraqitur ngjarje të cilat në disa raste i kanë anatemuar. Në një shkrim që shkruan Naxhi Ndoci për këta dy piktorë, thotë: të dy punojnë në stilin e kubizmit të hershëm francez, të dy punojnë me teknikën e vajit në pëlhurë dhe të dy punojnë të motivuar nga folklori popullor.¹

Por, këta dy piktorë kanë edhe të veçantat e tyre, vërtet janë të motivuar në folklorin popullor, por piktori Rexhai Iseni më shumë ishte i fokusuar tek shprehja vizuale e jetës së përditshme sociale, paraqitja e ornamenteve folklorike dhe mënyrën e jetesës. Ndërsa piktori Mexhit Bajrami më shumë pikturon ngjarjet historike, me anë të figurave simbolike, shpreh edhe mesazhet e ngjarjes që kanë ndodhur. Ishte koha kur në Maqedoni në territoret e banuara me shqiptarët autokton mungonin mësuesit, koha kur familjet shqiptare me shumë sakrificë e mund i shkollonin fëmijët e tyre dhe u krijonin kushtet për zhvillimin e mësimin në gjuhën shqipe nga mësues të kualifikuar.

Të dy artistët i përkasin kësaj kohe të vështirë shkollimi. Por, njëkohësisht edhe mësuesit e parë të artit figurativ që shërbyen në fshatrat e tyre, pa e lënë pas dore pasionin e pikturës. Fillimet e tyre të punës artistike kishin qenë në stilin e realizmit, por më vonë vazhduan punën e tyre të frymëzuar me stilin modern të kubizmit, si stil i cili kishte marr hov kudo në botë që në vitet 1908–1914 nga piktori Pablo Picasso dhe Gjorgj Brak,² i pëlqyer edhe në ditët e sotme. Rexhai Iseni në një intervistë shprehet për pikturën e tij - “Te kubizmi gjeta që të shpreh të gjitha preokupimet e mia.

Nëpërmjet vijave të drejta dhe trajtave gjeometrike arrija dinamizmin e figuracionit të (për)thyer si mundësi shprehjeje e fisnikërisë dhe gufimit emocional”.³ Ndërsa krijimtaria e Mexhit Bajramit ka kaluar në disa cilke stilesh duke eksperimentuar, e që në kohën e fundit është duke punuar plotësisht në stilin surrealist me karakter historik. Pas Luftës së Parë Botërore simbolet kombëtare shqiptare në Maqedoni ishin shumë të kufizuara, mos të themi ishin të ndaluara fare, po përmendim këtu plisin e bardhë të cilin e hoqën me dhunë, vranë qeleshepunuesit në shumë vende të trojeve shqiptare.

¹ Flaka e Vllaznimit 16. prill 1969 Respektimi i shprehjes klasike shkruar nga Naxhi Ndoci fq. 6.

² H. H. Arnason Istorija moderne Umetnosti Publikum Beograd 2002 fq. 156.

³ Mixhait Pollozhani, <http://shenja.mk/index.php/profil/5226-kubisti-i-shpateve-te-karadakut.html>. Studim shkencor - Rexhai Iseni - Kubisti i shpateve të Karadakut, Shenja, 88 – 90, Shkup, nr. 30, tetor, 2013.

Kjo ngjarje ndodhi nga vitet 1917-1921 kur të gjithë burrave shqiptarë nuk iu lejua plisi i bardhë, por vetëm kapuçi i zi⁴. Dhe që nga ajo kohë, çdo i ri në moshën e pjekurisë mbante kapuç në kokë për t'u identifikuar që ishte shqiptar e në rast se ndonjë nuk mbante kapuç e quanin “shka”. Por edhe sllavët mbanin kapuç të zi, por dallohej nga forma e kapuçit të shqiptarëve dhe quhej “shubara”.

Nga intervistat në rajonin e Kumanovës, të intervistuarit shprehen; “...përpara si kan lan mu hungj me hangër buk n'sofër pa e pas kapuçin nkrije,... – pse, shka thojshin pa kapuç....”⁵, profesor Bajrami thotë; “...unë der sa e kam kry gjimnazin s'um ka lan baba të hy në shtëpi pa kapuç, as buk s'kam pas shancë t'ha, t'ulesh n'sofër t'hajsh buk jooooo hiq ... e po musliman feja...”⁶.



Edhe rrobaqepësi i parë shqiptar në Kumanovë tregon historinë e tij të fëmijërisë, se sa të vështirë e kishte pasur mbajtjen e kapuçit; “... tinza, se pa kapuç nuk ke mujt me hangër darkë,...si dilsha kapuçin n'xhep e majsha kur hisha n'shpi e vnojshta,... po de pi zorit shka me ba...”⁷.

Zakonisht të rinjtë që nuk e pëlqenin ta mbanin kapuçin ishin ata të cilët kishin filluar të lexonin, e disa prej tyre, të dilnin për ndonjë tregti apo ndonjë shërbim familjar edhe në vende të tjera të ish Jugosllavisë. Por shumica e kuptonin se kapuçin e mbanin vetëm për shkak të besimit fetar sepse feja ishte ajo që kishte pushtet në mendësinë shqiptare, veprimtaria e klerit të diktuar nga politikat sllavo-maqedone me qëllime shkatërrimtare. Kjo ishte arsyeja pse një pjesë e madhe e popullsisë, mbajtjen e kapuçit e konsideronin si ligj fetar.

⁴ Kadri Halimi, Studime Etnologjike, Prishtinë, 1994, Shënimet e para te qeleshe punuesev fq. 152-172.

⁵ Rexhep Qail Jashari 70 vjet bujk-çoban, fshati Allashec 5 vjet shkollë në fshatin Sllupçan.


⁶ Bajram Shaban Ademiti i lindur 18.06.1948 në Kumanovë, të ardhur nga fshati Likovë në fund të shek. XIX, me profesion arsimtar i Kimi-Biologjisë.

⁷ Hajrulla Bislimi i lindur më 1935 në fshatin Llojan, profesioni rrobaqepës në Kumanovë, jeton në New York-Amerikë.

Pikërisht në veprat artistike të këtyre piktorëve kemi të paraqitur veshjen shqiptare me plisin e bardhë, karakteristikë e veshjes popullore shqiptare të cilat shumë bukur i përshkruan Prof. dr. Afërdita Onuzi në studimin “Veshjet popullore simbol identifikimi” kur e përshkruan formën e kapuçit për secilën zonë, për zonën e Karadakut në fshatrat e Sharrit e ato të Kumanovës thotë se, shqiptarët mbanin kapuçin me formë gjysmë sferike me majë më të gjerë⁸.

Veprat “*Fshatari*” e piktorit Rexhai Iseni dhe “*Dragobia*” e piktorit Mexhit Bajrami, janë të punuara me stile të ndryshme R.H. në stilin tipik kubist, një pikturë me shumë kolorit dhe elemente folklorike. Fshatari në këtë pikturë është i veshur me tirqit dhe jelek të kuq e këmishe pëllore të bardhë, këtu piktori paraqet burrin shqiptar me kostum tradicional. Përmes kësaj pikturë janë të paraqitura edhe mjetet e punës së zdrukthëtarit: sharra e drurit dhe sopata. Në këtë zonë është zhvilluar edhe drugdhendja dhe veglat e punës e të përpunimit të drurit janë të shumta.

Punoheshin maxhe shpeshherë të zbukuruar, enë, lugë, pjata, kosha, hambarë për mbajtjen e drithërave të ndryshëm, orendi druri, sofa, arka që shërbenin për të ruajtur rrobat e reja dhe pajën e nuseve ose të vajzave etj. Piktori M.B. punoi pikturën në stilin mes surrealizmit dhe kubizmit ku paraqitet trimëria dhe pozicioni i shqiptarit në mbrojtje të familjes dhe atdheut. Skenë e një realiteti në këtë zonë, shqiptarët çdo herë ishin të sulmuar në forma të ndryshme, jetonin me pushkë në dorë, tonaliteti i pikturës tregon ngjarjen e zhvilluar natën ku dallohet portreti surrealist i shqiptarit me plis të bardhë.



Nga vet emri i pikturës kuptohet se piktura i kushtohet heroit tonë kombëtarë Bajram Curri i idealizuar në shpellën e Dragobisë. Unë bëra një krahasim të këtyre dy pikturave për të treguar vazhdimësinë e plisit të bardhë të fshatarit kumanovar dhe heroit tonë kombëtar si element tradicional i veshjes për burrat shqiptarë të veriut, por i paraqitur me shumë mjeshtri nga dy piktorët kumanovarë.

Në një fotografi të vjetër të viteve të '40, në foto Nezir Rrahmani, fshatari mban në kokë plisin e zi, por jo kapuçin e bezit të qepur. Në disa zona (jo të gjithë) e përjetuan rëndë heqjen e plisit të bardhë. Dhe, asnjëherë nuk e mbajtën në kokë kapuçin e bezit të zi, por plisin e bardhë edhe pse e siguronin me shumë vështirësi nga qeleshepunuesit e Kosovës, e ngjyrosnin me ngjyrë të zezë dhe e mbanin shpeshherë të

⁸ Afërdita Onuzi – Kultura Popullore 1, 2 Tiranë, 2008, Veshjet popullore simbol identifikimi fq. 15.



mbështjellë me “qevrën” shaminë e pambukut të cilën, të dy piktorët e paraqesin në shumë momente në pikturat e tyre.

Piktori M.B. në bazë të intervistës tregon se në atë pikturë është paraqitur edhe jeta e fshatarit që jeton me pushkë në dorë, mbron pragun e shtëpisë, shqiptarët në këtë zonë çdo herë ishin të sulmuar në forma të ndryshme. Ngjyrat në këtë pikturë janë monokromë dhe duket që gjithë ngjarja në pikturë zhvillohet në një ambient të errët. Në pikturën “Vallja e nuses” të M.B. të punuar në stilin e kubizmit, paraqitet vallja e nuses shqiptare. Figurat e femrave janë të veshura me dimi me ngjyra të ndezura.

I gjithë kompozicioni ka një kolorit që qëndron në harmoni me format kubike moderne, duke dominuar ngjyra kuq dhe zi me ornamente folklorike shqiptare. Sipas traditës është paraqitur mbrapa femrave paja e nuses në ditët para martesës, e cila realisht hapet në dhomë dhe shpërndahet në atë mënyrë që të duket çdo detaj, muret e dhomës i përdornin për të varur pajën.



Dy vajzat që vallëzojnë para nuses, janë të veshura me dimi (*dimija*) që tregojnë mënyrën e veshjeve të femrave shqiptare, ndikimin oriental në këtë zonë deri në vitet ‘60. Te nusja në mes me shami të kuqe në kokë e veshur me këmishë, te mëngët e saj, piktori parqet motive të stilizuara të shqiponjës, këto motive ashtu në formë dhe në ngjyrë origjinale i gjejmë edhe në qilimat që i mbanin në dhomat e burrave (*soba e burrave, oda soba e miqëve*), pothuajse në çdo shtëpi shqiptare që ishte pak në gjendje të mirë ekonomike. Në këtë pikturë nusja është në një moment të gëzuar, duke vallëzuar.

Lëvizja e duarve gjatë vallëzimit bashkë me vajzën në të djathtë krijojnë kokën e shqiponjës dy- krenare. Në dasmën tradicionale shqiptare në këtë kohë nusja qëndronte shumë statike me sy të ulur poshtë, por piktori në këtë pikturë paraqet fillesat e emancipimit të femrës shqiptare, që edhe ajo të gëzojë të luaj në ditën e saj të dasmës. Ky ishte varianti i parë që shpjegohet për këtë pikturë. Në fakt, në këtë pikturë autori shpjegon simbolikën e nuseve. Një shpjegim tjetër që deri më sot nuk është thënë asnjëherë.

Figura e nuses është nëna Shqipëri që mbanë edhe kurorën si mbretëreshë dhe afër saj vajzat e tjera që paraqesin pjesët e ndara të trojeve shqiptare, artisti në këtë rast i paraqet në valle të bashkuara, dëshirë e kamotshme e shqiptarëve. Ndryshe e paraqet momentin e dasmës piktori R. Iseni. Në pikturën “*Nusja*” piktori paraqet momentin e dasmës tradicionale. Edhe pse në stilin e kubizmit dallohet ngjarja – momenti shumë i dhimbshëm plot emocione të përziera, të cilat janë të reflektuara edhe në fytyrat e tri vajzave, kur vajza del nga shtëpia e prindërve.

Nusja në mes e veshur me të kuqe, këtu piktori paraqet dasmën e viteve ‘20 kur nusja ditën e dasmës vishte dimija të kuqe ose fustan të kuq. Në rajonin e Kumanovës dhe më gjerë në trojet shqiptare ishte zakon që nusja të qëndronte statike. Nga kjo pikturë shohim traditën shqiptare të dasmës, nusja me sy të ulur poshtë e heshtur sepse zakoni thotë që nusja nuk duhet ta shoh askënd pa e pa burrin, *(në disa raste kur nusja nuk rrinte mirë d.m.th me sy të ulur ia mbyllnin sytë me dyll ose me shërbet)*⁹.

Nusja nuk duhet t’i jepte dorën askujt pa ia dhënë dorën burrit, nuk duhej të flasë me askënd deri sa të flasë për herë të parë me burrin, sipas disa gojëdhënave këto rite bëheshin që nuses t’i pëlqej burri, pasi atë duhet ta shihte të parin dhe ai duhej t’i fliste i pari nuses si shenjë që fjala e tij çdo herë të dëgjohet si i pari familjes¹⁰. Në kokë mban duvakun e bardhë nga i cili i duket qartë fytyra e mërzitur. Po ashtu edhe dy vajzat që i qëndrojnë afër nuses janë të veshura me dimi jelek dhe këmishë pëlhere të bëra me vek (vegje) ku dallohen edhe vijat dekorative me ngjyrë kafe në te kuqe, në kokë kanë të lidhur shaminë. Piktori paraqet me shumë mjeshtëri momentin emocional të tri vajzave, kur shohim këtë pikturë, ky emocion përcillet tek shikuesi, duke përcjellur emocionin e trishtimit të nuses dhe vajzave.

⁹ Subije Ashimi - lindur më 1952 nga Vaksincë jeton në Sent Galen të Zvicrës – qëndistare me makinë.

¹⁰ Rabishe Bajrami – lindur më 1947 në fshatin Vaksincë e martuar në fshatin Llojan – amvise.



Ngjarje nga tradita e dasmës shqiptare janë të paraqitura edhe në pikturën “*Dy dahirexhiket*” (defatoret). Në dasmën shqiptare të Kumanovës zakonisht vajzat dhe bijat që mbledhen i bien dajreve (*dahireve*) edhe vajzat të tjera të familjes së gjerë, miqtë e të afërmit bashkohen në “kor” këndojnë.

Gjatë këndimit dahirexhiket komunikojnë përmes shikimit për këngën e radhës dhe përcjelljes së tingullit të dajreve (*dahireve*). Pamje të tilla shohim në raste fejese, martese ku vajzat si autore edhe të këngëve përkundër ngarkesës psikike dhe emocionale, përcjellin me konsekuencë traditën¹¹. Mënyra se si janë ulur, shikimi, komunikues, pozicionimi i duarve në instrument të gjitha janë përshkruar në mënyrë shumë origjinale. Po ashtu edhe veshja e vajzave të cilat janë të ulura, por dallohen që ato janë të veshura me fustan dhe poshtë kanë donet e gjata, jeleku tradicional i veshur sipër këmbës, tani me mëngë të shkurtër dhe në kokë mbajnë shaminë të lidhur për raste. Pasi i rregullonin flokët, lidhnin shaminë në pjesën e pasme të kokës, ndërsa anash krijonin lidhje dekorative të quajtur “*piskil*”, nga turqishtja *tufë*, lidhja bëhet në atë formë që të jenë të dukshme ojat e punuara me gjilpërë¹².



Veshjet solemne me ngjyra të hapura, mënyra e lidhjes së shamisë karakteristike në zonën e Kumanovës, lidhen në mënyrë harmonike me kompozicionin e mbrapa skenës. Po thuaj në të gjitha pikturat e Rexhai Isenit, femra paraqitet me duar të zhvilluara si simbol që tregon forcën femërore në punët e shtëpisë.

Tri femrat në tri momente pune, femra e parë në një dorë ka një enë bote të mbushur me kos dhe paraqitet në momentin e hedhjes së kosit në tli, për të bërë tëlyenin dhe dhallin, tjetra në magje druri të dekoruar, dhe e treta duke larë rrobat. Në të tri rastet kemi objekte të gdhendura druri që tregojnë zhvillimin e mjeshtërisë së drugdhendjes. Po ashtu kjo pikturë flet për pozicionin e femrës shqiptare në familje dhe detyrat e sajë në punët e shtëpisë.

¹¹Mumin Zeqiri, Nga Lirika familjare shqiptare e Kumanovës, Makedonska Riznica Kumanove 1995 fq.140-150.

¹² Mirsije Veliu – e lindur në vitin 1954 në fshatin Tërrnovc i Preshevës e martuar në Kumanovë.



Emancipimi i femrës ishte në nivel shumë të ulët, femra në Kumanovë ishte e lidhur pas punëve të shtëpisë¹³. Nuset merreshin me punët e shtëpisë, me pastrimin, me gatimet dhe me larjen e rrobave, të ndara me nga një javë secila në rrotacion. Në pikturën “Tradita”. Vet autori tregon: është paraqitur pozicioni i femrës shqiptare në familjen patriarkale, ndarja e punëve për gratë, për mënyrën e veshjes, në ditë të zakonshme pune jetese.

Pozicioni i gruas në bashkësinë e madhe familjare¹⁴. Diplomati dhe filologu austriak J.G.Von Hahn, gjatë udhëtimit nëpër Shqipëri krijoi bindjen se shqiptarët janë njerëz me karakter të fortë, mjaft të edukuar, si kolektivitet me një rend hierarkik edhe në biseda. Ai tregon se gjatë udhëtimit në Ballkan: - *“kur i pyesja një grup njerëzish të një kombi tjetër mundoheshin të gjithë përnjëherë të më ndihmonin; ndërsa kur pyeta një grup shqiptarësh , ata nuk nxitonin të më tregonin të gjithë përnjëherë, por me respekt të veçantë , lejonin që të përgjigjej më i vjetri ndër ta”*¹⁵.



Në pikturën “Kthimi nga fusha” paraqiten tre anëtarët e familjes. Këtu tregohet edhe rendi në familje, respektimi i pozicionit të babait dhe autoriteti i tij. Në sfond duket ara e mbjellë me duhan, kultivimi i duhanit në Kumanovë ka sjell gjithmonë përfitime dhe ka qenë mënyrë jetese e sigurimit të të ardhurave vjetore në shtëpi.

¹³ Mumin Zeqiri Nga Lirika familjare shqiptare e Kumanoves, Makedonska Riznica Kumanove 1995 fq.140-150

¹⁴ Rexhai Iseni, i lindur më 1939 në fshati Mateç, profesioni piktor-mësues i artit figurativ.

¹⁵ J.G.Von Hahn Reise von Belgrad nach Saloniki, Wien 1868 s.43-44 marr nga punimi studimor / Sabit Uka - Disa të dhëna të udhëpërshkruesve të huaj për shqiptarët e Sanxhakut të Nishit 1878 – 1912 / Gjurmime Albanologjike - Instituti Albanologjik, Prishtinë / Seria e shkencave historike Prishtinë 1993 / fq. 96.

Lindja e diellit që është i lidhur me kthimin në shtëpi kur punohej në fushën e mbjellë me duhan, pasi kanë mbaruar punët e fushës, kanë marr mjetet e punës. Kjo pikturë shpjegon mjete e punës dhe veshjen tradicionale të fshatarëve në ditë pune në arë. Babai me plisin e mbështjellë me çevre, të lëshuar pas qafës, vajza me shami, ndërsa djali mban kapuç të zi. Por, vlenë për t'u theksuar se asnjëherë në pikturat e artistëve shqiptarë nuk është pranuar kapuçi i zi si simbol tradicional.

Shumica e të intervistuarve shprehen se mbanin kapuçin e zi për t'u dalluar si të besimit mysliman nga sllavët. Të gjitha si pasojë e interpretimeve të pseudohoxhallarëve. Shteti maqedonas-jugosllav ushtronte dhunë shtetërore psikologjike, ekonomike e fizike ndër banorët shqiptarë, duke përdorë metoda të llojllojshme, një ndër metodat më efikase ishin predikuesit fetarë.

Pikërisht këtë temë e pasqyron në një pikturë (vepër artistike) piktori M. Bajrami të titulluar "*Tingujt e kohës*". Në këtë vepër paraqitet gjendja e shqiptarëve në Maqedoni në vitet e '50 – '60, koha kur ndodhën shpërnguljet e shqiptarëve për në Turqi, afërsisht pesëdhjetë përqind e banorëve të fshatrave shqiptarë u shpërngulën në Turqi. Në një studim, Qerim Lita shkruan: "Për zbatimin sa më parë të kësaj politike, J. B. Tito dhe kabineti i tij, gjatë vitit 1951, organizuan disa takime sekrete me ambasadorin turk në Beograd, Fuad Kyprili.

Ky diplomat, në këto takime, do të pajtohet që të ripërtërihet Konventa e para Luftës së Dytë Botërore, e arritur midis Turqisë dhe Mbretërisë jugosllave, e cila parashihte shpërnguljen e shqiptarëve nga këto vise për në Turqi¹⁶. Sa për fillim, të dyja palët ranë në ujdi, që Jugosllavinë ta vizitonin misionarë të ndryshëm turq, me detyrë speciale që në vendbanimet shqiptare të propagandonin politikën e shpërnguljes, sigurisht duke e lavdëruar Turqinë.

Pa vonuar shumë, kjo ide do të fillonte të zbatohet në praktikë, respektivisht disa qindra qytetarë të Republikës së Turqisë, gjatë verës së vitit 1951, do të qëndronin nëpër disa qendra të rëndësishme shqiptare, si në: Shkup, Tetovë, Kumanovë, Gostivar, Manastir etj. Gjatë kontakteve me të afërmit e tyre dhe me shtresat e ndryshme shqiptare, si me zejtarë, tregtarë, klerikë myslimane etj., lavdëronin Republikën e Turqisë".¹⁷ Piktori si dëshmitar okularë i ngjarjeve që jetonte në atë zonë i përjetoi, i dëgjoi të gjitha këto fakte.

¹⁶ Државен Архив на Македонија, Фонд ЦКСКМ, к. 29, док. 137. fq. 673-690 (në tekstin e mëtejme lexo: AM.1. 427. 29. 137/673-690, marrë nga – Qerim Lita, Shpërngulja e shqiptarëve nga Maqedonia në Turqi (1953-1959) ...fq. 76.

¹⁷ Qerim Lita, Shpërngulja e shqiptarëve nga Maqedonia në Turqi (1953-1959), Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup, 2009, Studime Albanologjike1 fq. 77.

Kishte pas rastin të dëgjonte propagandën e këtyre "hoxhallarëve", duke thënë nëpër oda se *"ne jemi turq dhe duhet të shkojmë në atdheun e të parëve tanë"*. Në Maqedoni e në tërësi në Jugosllavinë e atëhershme ekzistonin dy rryma të kundërta, njëra qeveritare që punonte për shpërnguljen e shqiptarëve në Turqi dhe rryma tjetër intelektualet shqiptare që e kuptuan dhe përpqeshin ta frenonin këtë fenomen, por fatkeqësisht dominonte e para¹⁸.

Në këtë pikturë të stilin surrealist është paraqitur simboli i hoxhës me çallmën dhe dy sy që dalin nga çallma. E paraqitur edhe shprehja popullore në këtë zonë që përdoret si mallkim *"të plaçin sytë"* pikërisht ky mallkim është paraqitur në këtë pikturë në stilin surrealist, në mënyrë simbolike është dhënë mesazhi për pseudohoxhallarët dhe gjykimi që i pret në të ardhmen.

Figura e një njeriu që mban në supe rrotën, simbol i kohës që ecën, nga e cila derdhet katran që simbolizon dënimet e kohës për ideologjinë dhe dëmet që krijuan në popullin shqiptar. Figura qëndron në këmbë e lidhur me katran e cila mundohet të mbahet në të, paraqitet sikur do të rrezohet me gjithë peshën që ka mbi supe. Lartë, qielli i vrenjtur nga retë i paraqitur në formë artistike surreale, gati sa nuk ka filluar një shi i fuqishëm sipër ngjarjes. Ndërsa në horizont, qielli fillon e hapet, simbol i shpresës për ditë më të mira.

Këtë pikturë e shohim në dy versione, pamja në të djathtë është pamja reale e pikturës, dhe ajo në të majtë është pamja aktuale pas luftës së Kosovës më 1999 e cila u gjet e copëtuar në një cep të oborrit, ku kishte kaluar më shumë se 3 muaj. Edhe një herë kësaj pikturë themi se i shtohet vlera dhe paraqitet në realitet dhuna fizike, urrejtja nga ata – autorë të ngjarjeve të dhimbshme për popullin shqiptar.

Përfundimi


Për kohën e mesjetës, për veshjet ilire i vetmi burim që dëshmon për shijen estetike të asaj kohe ishte qeramika e zbuluar në vendet ilire. Në shek. XVI element të tillë etnografik kanë përdorur në pikturat e tyre Onufrit dhe të birit të tij Nikollait. Për mënyrën e jetesës mësuam nga gërmadhat arkeologjike të gjetura kudo në botë¹⁹, edhe këto vepra arti janë material faktik për studimet e mënyrës së jetesës në këtë zonë, mënyrën e veshjes, traditën ndikimet, emancipimin, shkollën shqipe vuajtjet etj.

¹⁸ Po aty.

¹⁹ Aferdita Onuzi. Përdorimi i ngjyrosësve natyrorë dhe kimikë në tekstilet tona popullore Gjurmime Albanologjike Folklor dhe Etnologji 28-29 1998-1999 fq. 44-47.

Të dy artistët kanë një numër të madh të veprave artistike, por edhe artistë të tjerë që vazhduan zhvillimin e kulturës artistike kanë vlera të mëdha të artit që duhen studiuar. Nga një intervistë me autorët kuptojmë se, në ekspozitat e tyre kishte shumë pak vizitorë, kjo tregon edhe nivelin e zhvillimit të artit, por është edhe një dëshmi e jetës së vështirë të shqiptarëve në trojet e tyre. Kur të mungon Liria nuk ke kohë e dëshirë të merresh me art, por ja që edhe kjo pjesë shumë e rëndësishme e kulturës, d.m.th. arti nuk mbeti mbrapa pavarësisht kushteve dhe rrethanave e ndalesave.

Edhe artistët e rinj kontribuan e kontribuojnë edhe sot me artin tradicional që studiohet jo vetëm nga fusha e artit por edhe nga studiues etnolog, sociolog etj. nga të cilët mund të gjejmë materiale shumë të rëndësishme, do të përmend këtu edhe vizatimet e shtëpive tradicionale të piktorit të viteve '90, Dali Alili nga Kumanova, të cilat mund të konsiderohen si vizatime modele të shtëpive tradicionale që janë rrënuar pas konfliktit të armatosur në Maqedoni në vitin 2001 por janë të punuara në detaje ku dallohet forma dhe karakteristikat e asaj kohe.²⁰ Fatmirësisht sot në Kumanovë, arti shqiptar është në nivel të lartë, ka shumë emra të njohur të cilët po sjellin risitë e artit modern dhe po përfaqësojnë këtë zonë, pa lënë anash tematikat folklorike tradicionale.



Bibliografia

- Alili, Dali, 2018. Face Book. [Online] Tetorë, E hënë, 2018. https://mobile.facebook.com/dali.alili.75/albums/10202893428728372/?ref=content_filter#_.
- Arnason, H. H. 2003 .*Istoriya moderne Umetnosti* p.156. Beograd : Publikum, 2003 . 978-86-83305-41-4.
- Halimi, Kadri. 1994, *Shënimet e para te qeleshe punueseve / faqe152-172*, Prishtinë : Druckart, 1994, Instituti Albanologjik i Prishtinës.

²⁰ https://mobile.facebook.com/dali.alili.75/albums/10202893428728372/?ref=content_filter#_

Lita, Qerim 2009, Shpërngulja e shqiptarëve nga Maqedonia në Turqi (1953-1959) . [book auth.] Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve, *Studime Albanologjike I f. 77*. Shkup : Focus Print , 2009.

—. Shpërngulja e shqiptarëve nga Maqedonia në Turqi (1953-1959) fq. 76. [book auth.] Државен Архив на Македонија. Фонд ЦК СКМ, к. 29, док. 137. fq. 673-690 .

Onuzi, Aferdita, 1998-1999, Përdorimi i ngjyrosësve natyrorë dhe kimikë në tekstilet tona popullore f. 44-47. [book auth.] Folklor dhe Etnologji 28-29, *Gjurmime Albanogjike*, Prishtine : s.n., 1998-1999.

Onuzi, Afërdita, 2001, *Veshjet popullore simbol identifikimi f.15*. Tiranë : Kultura Popullore 1.2., 2001.

Respektimi i shprehjes klasike. Ndoci, Naxhi. 16 prill 1969 , Shkup : s.n., 16. prill 1969 , Vol. Flaka e Vllaznimit f. 6.

Rexhai Iseni - Kubisti i shpateve të Karadakut. POLLOZHANI, Mixhait. 30. Teto. 2013. 88-90, Shkup : s.n., 30. Teto. 2013, Vol. Shenja.

Uka, Sabit, 1993, Disa të dhëna të udhërshkruesve të huaj për shqiptarët e Sanxhakut të Nishit. [book auth.] Wien 1868 s.43-44 J.G.Von Hahn Reise von Belgrad nach Saloniki. *Seria e shkencave Historike*. Prishtinë : Instituti Albanologjik, 1993.

Zeqiri, Mumin. 1995. *Nga Lirika familjare shqiptare e Kumanoves, f.140-150* , Kumanovë : Makedonska Riznica , 1995. 9989-50-004-5.

Të intervistuar

Bajram Shaban Ademiti i lindur 18.06.1948 në Kumanovë të ardhur nga fshati Likovë në fund të shek. XIX, me profesion arsimtar i Kimi–Biologjisë.

Hajrulla Bislimi i lindur më 1935 nga fshatin Llojan prfesion i rrobaqepës në Kumanovë jeton në New York, Amerikë.

Mexhit Bajrami lindi më 1942 nga fshati Llojan, jeton në Fushë Kosovë. Profesion i piktormësues i artit figurativ.

Mirsije Velu – e lindur në vitin 1954 nga fshati Tërnovc i Preshevës e martuar në Kumanovë – amvise.

Rabishe Bajrami – lindur më 1947 në fshatin Vaksincë e martuar në fshatin Llojan –amvise.

Rexhai Iseni jetoi 1939- 2018 në fshati Mateç. profesioni piktormësues i artit figurativ.

Rexhep Qail Jashari 70 vjet bujk-çoban, fshati Allashec.

Subije Ashimi e lindur më 1952 nga fshati Vaksincë jeton në Sent Galen të Zvicrës – qëndistare me makinë.